BE për Rininë (EU4Youth)

Pyetje dhe Përgjigje në kuadër të Thirrjes për Projekt Propozime publikuar më 18 Qershor 2025

Nr.	Pyetje	Përgjigje
1	A janë të krijuara Rrjetet e Partneritetit Vendor, apo duhet të krijohen nga ne? A mund të kemi Draft Udhëzuesin Operacional për Rrjetin e Partneritetit Vendor?	Rrjeti i Partneritetit Vendor, është mekanizëm bashkëpunues, ngritja e të cilit parashikohet nga Plani Kombëtar i Zbatimit të Garancise Rinore, i miratuar me VKM Nr. 173, date 24.03.2023. Këto rrjete do të zbatojnë strategji informimi dhe kontakti mi për të rinjtë NEET, duke forcuar gjithashtu koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve parapërgatitore dhe përgatitore në kuadër të Garancisë Rinore. UNDP & UNICEF, në kuadër të projektit EU4Youth, po mbështet AKPA dhe AKR në ngritjen, formalizimin dhe funksionalizimin e këtyre mekanizmave. Kjo do të thotë, se këto mekanizma nuk janë ngritur ende formalisht, dhe në kuadër të kësaj thirrje synohet, ngritja, aktivizimi dhe fuqizimi i tyre. Të gjitha entitetet që do të përzgjidhen si fituese të kësaj thirrje, do duhet të nënshkruajnë një marreveshje partneriteti me Drejtoritë Rajonale të AKPA, të cilat do të koordinojnë rrjetin në nivel rajoni, për t'u bërë pjesë e rrjetit. EU4Youth ka mbështetur AKPA dhe AKR në hartimin e një manuali operacional për mënyren e funksionimit të këtij rrjeti që aktualisht është në versionin draft dhe mund ta gjeni këtu. DRAFT Udhezuesi Operacional_Rrjeti i si%20Operacional_R DRAFT%20Udhezue
2	A mundet të aplikojmë si OJF bashkë me një anëtar të Rrjetit të Partneritetit Vendor (për shembull Zyra e Punës), por pa pasur si bashkë-aplikantë bashkinë?	Zyrat e Punës dhe institucionet e tjera nën varësinë e AKPA-s janë përfituese të thirrjes dhe nuk mund të jenë bashkë-aplikantë. Thirrja përcakton se OSHC-të, në rolin e aplikantit kryesor mund të aplikojnë si një entitet i vetëm ose në konsorcium me bashkitë dhe/ose entitete të tjera, anëtarë të rrjetit të partneritetit vendor.
3	Bashkitë duhet të jenë bashkë-aplikantë (co-applicant) apo mund të jenë bashkëpunëtorë nëpërmjet nje letre mbështetëse?	Nuk është e detyrueshme që bashkitë të përfshihen si bashkë-aplikues. Njësitë e qeverisjes vendore mund të përfshihën edhe në rolin e bashkëpunëtorit. Në këtë rast, dorëzimi i një letre mbështetëse është i mundur, por nuk përbën dokument të detyrueshëm në paketën e aplikimit. Në rast kur OSHC, në rolin e aplikuesit kryesor vendos të perfshijë bashkinë si bashkë-aplikues (partner me rol dhe përgjegjësi në zbatim), është e nevojshme të nënshkruhet paraprakisht një Memorandum Mirëkuptimi i cili përcakton aspekte të menaxhimit dhe zbatimit të grantit.

4	Sa të disponueshme do të jenë institucionet relevante për Memorandumin e Bashkëpunimit në fazë aplikimi (proces) duke qenë se do ketë një numër te lartë organizatash? Si mund të evitohet mundësia e selektimit të organizatave nga institucionet relevante?	Partneritetet ne rastin kur institucionet janë bashkë-aplikues (partner me rol dhe përgjegjësi në zbatim), duhet të dakordësohen paraprakisht dhe kushtet e bashkëpunimit të jenë të qarta para aplikimit. Në rast aplikimi të përbashkët, ky bashkëpunim formalizohet me nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi (MoU) i cili duhet të dorëzhet si pjesë e paketës së aplikimit. Por, nuk është e detyrueshme që institucionet të përfshihen si bashkë-aplikues. Ato mund të përfshihen edhe në rolin e bashkëpunëtorit. Në këtë rast, dorëzimi i një letre mbështetëse është i mundur, por nuk përbën dokument të detyrueshëm në paketën e aplikimit. (shih më lart).
5	Kur pritet të punësohet Ndërmjetësi Rinor dhe për sa kohë? A do mbulohet 100% nga projekti?	OSHC ka detyrim të punësojë, të paktën një të ri/e 20–29 vjeç si Ndërmjetës Rinor, përgjatë gjithë periudhës së grantit. Ndërmjetësi/ja duhet të trajnohet nga OSHC dhe të mbështesë zbatimin e aktiviteteve. Profili i ndërmjetësit është i përcaktuar sipas modelit të miratuar nga Koordinatori Ekzekutiv i Garancisë Rinore (Shtojca 0). Ndërmjetësi Rinor, do të duhet të jetë pjesë e stafit që në fillim të projektit, CV e tij do duhet të dërgohet si pjesë e aplikimit dhe kostot lidhur me këtë rol do të duhet të reflektohen në buxhetin e projektit *(Seksioni 9)*.
6	A do të jetë kontrata që do të nënshkruhet një kontratë shërbimi apo kontratë partneriteti?	Në rast përzgjedhjeje për financim të projektit, OSHC-ja do të nënshkruajë një marrëveshje granti me vlerë të ulët/marrëveshje partneriteti me respektivisht UNDP dhe UNICEF, në varësi të lot-it për të cilin aplikon (*Seksioni 13- Kushtet për implementim)*
7	A mund të aplikojë Kamza?	Në rast se i referoheni mundësisë për të aplikuar nga ana e Bashkisë Kamëz, në cilësinë e bashkë-aplikuesit, thirrja përcakton se vetëm tre bashkitë pilot të Garancisë Rinore (Tirana, Shkodra, Vlora) e kanë mundësinë e aplikimit në konsorcium me OSHC-të. Në rast se i referoheni mbulimit gjeografik të ndërhyrjeve të propozuara, projekt-propozimet duhet të mbulojnë vetëm 3 bashkitë e targetuara në projekt. Çdo aktivitet jashtë mbulimit gjeografik të thirrjes nuk është i pranueshëm *(Seksioni 8.1 – Veprime të paparanueshme)*.
8	A mund të aplikojë një person juridik, kompani që realizon trajnime apo duhet të jetë patjetër OJF?	Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve në këtë thirrje përfshijnë OSHC (në rolin e aplikuesit kryesor apo bashkë-aplikuesit), si edhe bashki apo institucione të tjera shtetërore që janë pjesë e Rrjetit të Partneritetit Vendor (në rolin e bashkë-aplikuesit). Entitetet private mund të jetë pjesë e forcimit të qasjes gjithëpërfshirëse dhe të integruar, por jo në rolin e aplikantit apo të bashkë-aplikantit.
9	Nëse aplikojmë në Lot-in 2 dhe/ose Lot-in 3, a duhet që përfituesit NEET të jenë tashmë të regjistruar në skemën e Garancisë Rinore, apo mund të përfshijmë edhe të rinj që do të identifikohen dhe regjistrohen gjatë zbatimit të projektit?	Të rinjtë NEET që do të trajtohen me shërbime para-përgatitore dhe përgatitore përmes Lotit 2 dhe Lotit 3, do të duhet fillimisht të identifikohen dhe referohen në Garancinë Rinore nga entitetet që do të jenë përfitues të këtyre loteve. Këto entitete do të duhet të planifikojnë edhe strategji e aktivitete për identifikimin dhe referimin e tyre. Pra përfituesit NEET të projektit nuk duhet të jenë të regjistruar në skemën e Garancisë Rinore, por duhet të identifikohen, referohen dhe trajtohen me shërbimeve parapërgatitore ose përgatitore të Garancisë Rinore gjatë zbatimit të projektit.
10	Vocational Training për industri të caktuara - në këtë rast filmi/kinemaja - tek cili lot futet, tek LOT 3 apo 2?	LOT 2 fokusohet në lëvrimin e shërbimeve parapërgatitore dhe përgatitore për NEETs. Ndërkohë LOT 3, fokusohet në lëvrimin e shërbimeve lëvizëse për kontaktimin dhe ofrimin e shërbimeve parapërgatitore dhe përgatitore për të rinjtë NEET që jetojnë në komunitete të largëta, pa struktura

		punësimi. Në varësi të qëllimit dhe projekt-idesë tuaj mund të aplikoni në secilin nga këto 2 lote *(Seksioni 2 – Objektivat e Thirrjes dhe fushat prioritare, Lot 2 dhe Lot 3)*
11	Secila organizatë duhet ta shtrijë projektin domosdoshmërisht në 3 bashki? Dhe duhet me domosdoshmëri të realizojë 300+350+350 të rinj në secilën bashki?	Nuk është e detyrueshme që secila organizatë të zbatojë projektin në të 3 bashkitë e targetuara (Tiranë, Shkodër, Vlorë) dhe nuk është e detyrueshme të arrijë objektivat totale të specifikuar në thirrje. Çfarë kërkohet? • Projekti duhet të zhvillohet në të paktën një nga tre bashkitë e përfshira në thirrje (në një, dy ose 3 bashki). • Kuotat që përmenden në dokument janë objektiva në total për të gjithë thirrjen, jo për çdo organizatë apo konsorcium individualisht. UNDP dhe UNICEF do të sigurojnë që të gjitha projektet bashkërisht të arrijnë indikatorët dhe qëllimet për secilin lot të Thirrjes. Përmes *shtojcës 4 ''Deklarata e qëllimit''*, kërkohet që të përcaktoni target grupet e NEETs që do të mbuloni dhe numrin e përfituesve që angazhoheni të përfshini.
12	Çfarë kuptohet konkretisht me "shërbime parapërgatitore" dhe "përgatitore"?	Shërbimet parapërgatitore dhe përgatitore janë komplementare dhe kanë një qëllim të përbashkët: mbështetjen e të rinjve NEET në tranzicionin e tyre drejt punësimit, arsimimit apo trajnimit. Dallimi midis tyre qëndron kryesisht në natyrën e mbështetjes që ofrohet. Shërbimet parapërgatitore janë të dizajnuara për NEET më vulnerabël, të cilët përballen me barriera të shumëfishta dhe komplekse, të tilla si mungesa e aftësive bazë, vështirësi ekonomike apo sfida në familje. Këta të rinj kanë nevojë për mbështetje thelbësore për të zhvilluar aftësi të domosdoshme si: shkrim-leximi, vetëbesimi dhe aftësi sociale, faktorë që, në të kundërt, mund t'i pengonin të përfitonin nga shërbimet përgatitore të Garancisë Rinore. Shërbimet përgatitore ofrohen, nën koordinimin e zyrave të punës, pasi i riu regjistrohet zyrtarisht në skemën e Garancisë Rinore. Në përputhje me angazhimin e Garancisë Rinore për të ofruar një mundësi cilësore brenda katër muajve nga regjistrimi, këto shërbime janë të kufizuara në kohë (deri në katër muaj) dhe synojnë të rinjtë që janë më pranë rikthimit në arsim, trajnim apo punësim. Ato përfshijnë mbështetje si orientimi për karrierën, trajnimi për rritjen e aftësive për punësueshmëri (intervistim, përgatitje e CV-së etj.), për të përgatitur të rinjtë që të përfitojnë nga oferta konkrete që u jepet nga zyrat e punës *(Seksioni 2 – LOT II Përshkrimi & Seksioni 4 – Aktivitete Indikative)*
13	Propozimet për projekte duhet të targetojnë të treja bashkitë së bashku apo një prej tyre është e mjaftueshme?	Projekt propozimet mund të targetojnë një, dy apo edhe tre nga bashkitë në fokus *(Seksioni 6 –Vendndodhja e Veprimit).*
14	Lidhur me numrin e përfituesve që pritet të targetohen nga secili Lot - a pritet që një aplikant të targetojë të gjithë numrin total të të rinjve të përcaktuar për secilin Lot apo do të ketë disa projekte për secilin Lot dhe pritet qe secili prej tyre të targetojë një	Nuk pritet që një aplikant apo konsorcium i vetëm të targetojë numrin total të përfituesve për secilin Lot. Për secilin Lot do të përzgjidhen disa projekte nga aplikantë të ndryshëm, dhe secili projekt do të kontribuojë me një numër të caktuar përfituesish, derisa të arrihet objektivi total i Lot-it. *(Seksioni 3 – Përfituesit Finalë të Synuar)*

	numër të caktuar përfituesish që në total do të arrijnë numrin total të pritshëm të përfituesve?	
15	Është e nevojshme të dorëzojmë një letër angazhimi ose mirëkuptimi nga institucionet përgjegjëse lokale, si p.sh. AKPA apo bashkitë, që në fazën e aplikimit, apo nëse mjafton që bashkëpunimi të përshkruhet në propozim dhe të formalizohet më pas në rast përzgjedhjeje.	Kjo varet nga strategjia juaj. Dorëzimi i një letre mbështetëse është i mundur, por nuk përbën dokument të detyrueshëm në paketën e aplikimit. Nëse po mendoni të aplikoni në konsorcium me bashkitë apo institucione të tjera të Rrjetit të Partneritetit Vendor si bashkë-aplikantë, atëherë duhet të dorëzoni një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) të firmosur që në fazën e aplikimit. Ndërkohë AKPA është përfituese e këtij projekti dhe nuk mund të jetë bashkë-aplikuese.
16	A lejohen rimbursimi i shpenzimeve të transportit për përfitues? Nëse po, a lejohen shpenzimet cash? Pasi një pjesë e madhe e përfituesve nuk kanë llogari bankare.	Kostot për trajtimin e barrierave të pjesëmarrjes për përfituesit dhe rimbursimi i tyre lejohet, por duhet të jenë të mirë-argumentuara dhe në përputhje me standardet dhe përcaktimet e specifikuara në thirrje *(Seksioni 8. - Konsiderata të Tjera).*Menaxhimi i kostove duhet të jetë në përputhje me manualet dhe procedurat financiare të aplikantit. Në rastin e mungesës së llogarive bankare, për të evituar përdorimin e cash, sugjerohet përdorimi i çeqeve bankare. Në çdo rast, zbatuesi i projektit duhet të mbajë dokumentacion të plotë dhe të rregullt verifikues të shpenzimeve të çdo natyre.
17	A mund të aplikojë vetë qendra e trajnimit profesional e regjistruar ne gjykatë si OJF? Nëse po, në cilët nga lotet?	Cdo entitet i regjistruar si OJF dhe që plotëson kushtet e përcaktuara në *Seksionin 9 "Pranueshmëria e aplikantëve"* ka të drejtë të aplikojë në secilin nga lotet, në varësi të qëllimit të projekt-idesë tuaj.
18	Dokumentat e detyrueshëm *'Mandatory supporting documents'* janë njësoj si për aplikantin kryesor ashtu edhe për bashkë-aplikuesin (co-applicant)?	Dokumentat mbështetës të detyrueshëm nuk janë plotësisht njësoj si për aplikantin kryesor (lead applicant) ashtu edhe për bashkë-aplikantin. Për aplikantin kryesor (lead applicant) dokumentat mbështetës të detyrueshëm janë përcaktuar në *Seksionin 10.1*. Për bashkë-aplikantin (co-applicant) dokumentat mbështetës të detyrueshëm janë përcaktuar në *Seksionin 10.3.*
19	A është e mundur të këtë një përzierje të Lot 1 dhe Lot 2 për disa nga llojet e aktiviteteve apo secili Lot duhet të jetë i fokusuar?	Në cdo rast projekt ideja duhet të përmbushë qëllimin dhe objektivat e secilit Lot, sipas përshkrimit në thirrje. Të rinjtë NEET që do të trajtohen me shërbime para-përgatitore dhe përgatitore përmes Lotit 2 dhe Lotit 3, do të duhet fillimisht të identifikohen dhe referohen në këto shërbime nga entitetet që do të jenë përfitues të këtyre loteve. Këto entitete do të duhet të planifikojnë edhe strategji e aktivitete për identifikimin dhe referimin e tyre *(Shih pyetjen 8).*
20	Qendra e Teknologjisë Tiranë, është pjesë e subvencioneve për Garancinë Rinore, si qendër trajnimi e cila i ka kaluar kriteret nga AKPA. Kërkohet marrëveshje me AKPA dhe Bashki. A është e mundur që një OJF,	Në dokumentin e thirrjes parashikohet se : "Të gjitha entitetet e përzgjedhura për të zbatuar aktivitetet në kuadër të këtij Thirrje për Propozime, do të duhet të nënshkruajnë një marrëveshje partneriteti me Drejtorinë Rajonale të AKPA-së në bashkinë ku do të veprojnë." Kjo do të ndodhë vetëm për entitetet që do të përzgjidhen. Ndërkohë, çdo OSHC që është e interesuar të aplikojë me bashkinë si bashkë-aplikant (co-applicant) do të duhet të nënshkruajë, dhe dorëzojë si

	realisht, të firmosë me drejtorin e institucioneve më lart, një marrëveshje bashkëpunimi?	pjesë e aplikimit, një MoU, sipas fortmatit të Shtojcës 5 *(Seksioni 9 – Pranueshmëria e aplikantëve).* Nëse bashkia do të përshihet, por jo në cilësinë e bashkë-aplikantit, marrëveshja e partneritetit do të mund të nënshkruhet pasi OSHC është përzgjedhur për financim. Ndërkohë AKPA është përfituese e këtij projekti dhe nuk mund të jetë bashkë-aplikuese.
21	A keni ndonjë sugjerim mbi mënyrën se si duhet të ndahet buxheti ndërmjet partnerëve të konsorciumit?	Në përputhje me objektivat e LOT-eve përkatëse, në funksion të metodologjisë së propozuar, hartimi i buxheteve të propozimeve dhe ndarja midis partnerëve të konsorciumit do duhet t'i përgjigjet aktiviteteve dhe planit të punës.
22	A mund të sqaroni çështjet/ problemet/ aktivitetet që mund të propozohen?	Çështjet dhe problemet që Thirrja për Propozime synon të adresojë janë specifikuar në *Seksionin 2 "Objektivat e thirrjes dhe cështjet prioritare".* Një listë aktivitetesh potenciale për secilin lot është paraqitur në *Seksionin 4.* Kjo listë aktivitetesh është orientuese dhe nuk synon të jetë shteruese. Aplikanti mund të propozojë metodologjinë dhe planin e tij të aktiviteteve, për sa kohë që ato përmbushin objektivat, prioritetet dhe rezultatet e pritshme për secilin lot.
23	Në këtë thirrje mund të aplikojnë vetëm organizata nga bashkitë e Shkodrës, Tiranës, Vlorës apo edhe qarqeve përreth? Qarku Vlorë përfshin edhe Sarandën e Delvinën. A mundet të aplikojnë organizata nga këto pjesë të Shqipërisë?	Në S*eksionin 9 "Pranueshmëria e Aplikantëve"* janë përcaktuar qartë kriteret për OSHC-të e interesuara për thirrjen. Kriteret përcaktojnë se organizatat që aplikojnë në këtë thirrje duhet të jenë organizata jofitimprurëse, të regjistruara ligjërisht dhe që operojnë në Shqipëri (në përputhje me Ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001) si edhe të paktën njëri midis aplikuesit kryesor ose bashkë-aplikuesve duhet të jetë aktiv në bashkitë e targetuara. Gjithashtu thirrja parashikon që aktivitetet duhet të zhvillohen në një ose më shumë nga tre bashkitë pilote të Garancisë Rinore, Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.
24	A supozohet që Loti 1 të mbulojë kosto projekt-propozimesh për të tre bashkitë? Apo secila bashki ka buxhet të ndarë?	Thirrja përcakton se *"UNDP dhe UNICEF do të përpiqen të shpërndajnë fondet në mënyrë të balancuar në bashkitë target, në kapacitetet e tyre më të mira."* Kjo do të thotë se nuk ka një ndarje të paracaktuar të buxhetit për secilën bashki për asnjë nga të tre Lotet, por synohet që financimi të mbulojë të tre bashkitë në mënyrë të balancuar, në varësi të cilësisë së aplikimeve dhe mbulimit gjeografik të propozuar.
25	Në rast se organizata e ka selinë qëndrore në Tiranë, por do të aplikojë në Shkodër/ Vlorë, sepse ka implementuar programe të ngjashme në të kaluarën. A na pengon kjo për të aplikuar në një qytet tjetër, i ndryshëm nga Tirana?	Thirrja për propozime nuk e ndalon aplikimin në një bashki të ndryshme nga ajo ku ndodhet selia qendrore e organizatës, për sa kohë organizata dëshmon se ka qenë aktive në bashkitë e targetuara. Siç përcaktohet në thirrje: *"Të paktën njëri midis aplikantit kryesor (lead applicant) ose bashkë-aplikantëve (co-applicants) duhet të jetë aktiv në bashkitë target." (Seksioni 9 – Pranueshmëria e Aplikantëve)*.
26	Organizata jonë aktualisht po zbaton nje projekt, në kuadër të skemës së granteve të projektit EU4LMI me fokus punësimin e të rinjve që nuk degjojnë. A mundemi të aplikojmë në këtë thirrje me qëllim trajnimin e të rinjve në	Çdo entitet që përmbush kriteret e pranueshmërisë të specifikuara në dokumentin e thirrjes ka të drejtë të aplikojë në thirrjen për propozime të EU4Youth. Në këtë rast, organizata duhet të sigurojë që aktivitetet, përfituesit dhe kostot të mos mbivendosen. Aplikimi duhet të jetë i fokusuar në objektivat specifike të kësaj thirrjeje. Gjithashtu është e rëndësishme të tregoni se organizata ka kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar një projekt të ri.

	Lot 2 për soft skills dhe kurse trajnimi?	
27	Në dokumentetin e thirrjes theksohet inkurajimi i aplikimeve të përbashkëta më bashkitë, dhe, në këtë rast theksohet se duhet të ketë një memorandum bashkëpunimi. Ndërkohë, në këtë rast a do konsiderohet bashkë-aplikant njësia e pushtetit vendor? Ndërkohë përcaktohet që edhe bashkë-aplikanti duhet të plotesojë të gjithë kriteret e aplikantit? Pra, a mund të jetë bashkia bashkë-aplikant?	Po, bashkia mund të jetë bashkë-aplikant, dhe në këtë rast duhet të dorëzohet, si pjesë e aplikimit, një Memorandum Mirëkuptimi midis aplikantit kryesor dhe bashkë-aplikantit/aplikantëve *(Shtojca 5).* Lidhur me kriteret që bashkia duhet të plotësojë në cilësinë e bashke-aplikantit ju lutem referohuni *Seksionit 9* të thirrjes për grante.
28	Nëse LGU/AKPA konsiderohen bashkë-aplikant (co-applicant), ato kanë të drejtë të jenë si të tillë vetëm në 2 projekte. Mos ndoshta kjo kufizon aplikimet, pasi këto aktorë janë të rëndësishëm për zbatimin e projektit. A mund të konsiderohen këto institucione vetëm partnere dhe jo co-applicant dhe te përcaktohen si të tillë në MoU? Ose të konsiderohen partnerë të asociuar?	AKPA është përfituese e këtij projekti dhe nuk mund të jetë bashkë-aplikuese. Në rastin kur OSHC-të dhe bashkitë dakordësohen të aplikojnë duke patur bashkinë si bashkë-aplikues, nënshkrimi dhe dërgimi i një MoU midis palëve është i detyrueshëm. Bashkitë apo edhe institucionet e tjera të Rrjetit të Partneritetit Vendor mund të përfshihen edhe në rolin e partnerit, duke u identifikuar si të tillë përmes një letre mbështetëse. Në këtë rast, dorëzimi i një letre mbështetëse është i mundur, por nuk përbën dokument të detyrueshëm në paketën e aplikimit.
29	Kur thuhet se aplikanti duhet të jetë aktiv në zonën që targetohet cfarë nënkuptohet? Duhet të ketë zbatuar projekte të mëparshme në këtë zonë? Një organizatë që regjistrohet në gjykatë është e ligjshme për të vepruar në të gjithë territorin e vendit. A e kufizon kjo mundësinë për aplikim vetëm në organizatat lokale?	Në *Seksionin 9 'Kriteret e Pranueshmërisë"* përcaktohet se *"Të paktën njëri midis aplikuesit kryesor ose bashkë-aplikuesve duhet të jetë aktiv në bashkitë e targetuara".* Edhe pse një OSHC është e regjistruar si ent kombëtar dhe ka të drejtë ligjore të veprojë në gjithë vendin, për këtë thirrje kërkohet dëshmi praktike e angazhimit në bashkinë e targetuar. Për të argumentuar aktivitetin në një bashki të caktuar, një organizatë nuk ka domosdoshmërisht nevojë të ketë selinë atje, por duhet të dëshmojë angazhim real dhe të vazhdueshëm në territor. Kjo mund të përfshijë zbatimin e projekteve të mëparshme në atë bashki, partneritete aktive me institucione vendore e organizata vendore. Gjithashtu, praninë e stafit apo bashkëpunëtorëve në terren, pjesëmarrjen në nisma komunitare si fushata, trajnime apo aktivitete të tjera, si dhe përfshirjen e një bashkë-aplikuesi lokal që plotëson kriterin e përvojës në zonë. Këto elementë tregojnë një lidhje të qëndrueshme dhe njohje të mirë të kontekstit lokal.

30	A ka limitim në numrin e partnerëve për thirrje? A mund të ketë më shumë se një bashkë-aplikant (co-applicant)?	Çdo projekt mund të ketë një aplikant kryesor (lead) dhe maksimumi 2 bashkë-aplikantë.
31	A është detyrim integrimi i moduleve SCUL në Lot 2?	Referuar thirrjes për propozime, Loti 2 nuk parashikon detyrim për integrimin e moduleve SCUL.
32	A është taksative që një organizatë të aplikojë vetëm në një LOT? Në rast se është e lejueshme aplikimi në dy LOTe, cilave dokumenta për aplikim duhet t'ju referohemi?	Një entitet mund të aplikojë si aplikant kryesor vetëm në një lot, por mund të marrë pjesë si bashkë-aplikues në maksimumi 2 propozime të tjera, pra gjithsej maksimum 3 aplikime (1 si lider, 2 si bashkë-aplikantë). Dokumentat mbështetëse për aplikantin kryesor përcaktohen në *Seksionin 10.1 dhe 10.2,* ndërsa për bashkë-aplikantin përcaktohen në S*eksionin 10.3.*
33	A duhet domosdoshmërisht që një organizatë të targetojë numrin total të NEETs që është parashikuar për secilin lot?	Kuotat e përfituesve që përmenden në dokument janë objektiva në total për të gjithë lotin, jo për çdo organizatë individualisht. UNDP dhe UNICEF do të sigurojnë që të gjitha projektet bashkërisht të arrijnë indikatorët dhe qëllimet për secilin lot të thirrjes. Ndërkohë, nëpërmjet shtojcës 4 ''Deklarata e Qëllimit'', kërkohet që të përcaktoni target grupet që do të mbuloni dhe numrin e përfituesve që angazhoheni të përfshini.
34	Në rast se ne do të dakordësojmë një marrëveshje bashkëpunimi me një bashki vendore, do të duhet të përdorim formatin e marrëveshjes që ju keni vënë në dispozicion?	Jo, nuk është e detyrueshme të përdoret domosdoshmërisht formati i MoU i vënë në dispozicion (Shtojca 5). Aplikantët kryesorë dhe bashkë-aplikantët e tyre mund të përdorin formatet e tyre të brendshme për të rregulluar aspektet e menaxhimit dhe zbatimit të projekt-propozimit. Cilësia e menaxhimit dhe koordinimit të propozuar do të jetë pjesë e vlerësimit të kapaciteteve të partnerëve.
35	A mund të qartësojmë afatin për dorëzimin e aplikimeve?	Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 18 korrik 2025, ora 24:00.
36	Aplikimi duhet të jetë në anglisht? Dokumentacioni mbështetës, përvec MoU dhe CV-ve të stafit është në shqip. A duhet përkthyer dhe noterizuar?	Formatet e paketës së aplikimit duhet të jenë të plotësuara në anglisht, duke përfshirë edhe MoU. MOU-në mund ta nënshkruani në gjuhën shqipe dhe më pas ta përktheni në anglisht. CV e burimeve njerëzore që propozohen për zbatimin e projekteve duhet të jenë në anglisht si pjesë e paketës së aplikimit. Dokumentacioni mbështetës nuk ka nevojë të përkthehet apo noterizohet.
37	Ne kemi një koncept-ide që duam t'a diskutojmë me ju, para se t'a konkretizojmë me aplikim. Kjo është e rëndësishme për ne, pasi duke qenë se target grupi i NEET është relativisht i vështirë, për të minimizuar risqet, një konsultim do ishte i vlefshëm. Nëse kjo është e mundur, ne jemi të gatshëm për takim si fizikisht, ashtu edhe online, kurdo që të jetë e mundur.	Në përputhje me rregullat e përcaktuara në thirrjen e publikuar, të gjitha pyetjet dhe kërkesat për sqarime mund të dërgohen vetëm me shkrim, në adresën e e-mailit të specifikuar në thirrje, deri më datë 2 Korrik 2025. Për këtë arsye, zhvillimi i takimeve individuale me organizatat e interesuara, qoftë fizikisht apo online, nuk është i parashikuar, me qëllim që të garantohet transparencë dhe një trajtim i barabartë për të gjithë aplikantët.

38	A mundet të na dërgoni Udhëzuesin Operacional për funksionimin e RrPV?	Shih pyetjen 1.